

**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE**  
**"V.A-21" sh.p.k**

Sot në datën 25.06.2021, z. Ardian Dardha dhe z. Ervis Sallufi, vendosen themelimin e shoqërisë "V.A-21" sh.p.k me terma si më poshtë:

**NENI 1**

Shoqëria Tregtare "V.A-21" sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statutit të miratuar prej saj.

**NENI 2**

**Emri i shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin "V.A-21" sh.p.k

**NENI 3**

**Objekti i veprimtarisë**

Shoqëria do të ketë si objekt:

*"Bar kafë. Shërbim në adresën e subjektit ose take away për tregtim të artikujve të ndryshëm ushqimor me shumice dhe pakice, pijeve të gjitha llojeve, brenda dhe jashtë vendit, tregtia me pakice në dyqane jo të specializuara me mbizotërim ushqimor, pije dhe duhan, shitje me pakice të ëmbëlsirave, produkteve prej mielli, dhe produkteve sheqeri në dyqane të specializuara, vetëm për shërbim take away, aktivitetet e shërbimeve ushqimore të tjera të cilat shërbehen vetëm take away, përpunim i kafes dhe çajit, market për produkte ushqimore, dhënia me qira dhe funksionim i pasurive të paluajtshme të veta ose të marra me qera, shërbime coffe shop etj..."*

**NENI 4**

**Selia e Shoqërisë**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rr. "Kongresi i Përmetit", pallati 180, shkalla 3, pasuria me nr. 3/88, zk. 8350.

**NENI 5**

**Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) Euro, i ndarë në 2 (dy) kuota.

Kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë janë të ndara si më poshtë:

*Ervis Sallufi*

1



## NENI 9

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

## NENI 10

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

## NENI 11

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

## NENI 12

### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.


## NENI 14

### Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi hartohet në 5 (pesë) kopje.

## ORTAKËT

**Ardian Dardha**



**Ervis Sallufi**



1. **Ardian Dardha**, i biri i Esat-it, i lindur më 20.02.1970, në Ballaj, Emigrant, ALB dhe banues në Rr. "Neki Libohova", Durrës, mbajtës i kartës së identitetit me nr. Personal H00220077L, në cilësinë e ortakut që zotëron 50% të vlerës së kuotave e barabartë me 1 kuotë me një vlerë të përgjithshme 15 000(pesëmbëdhjetë mijë)Euro dhe

2. **Ervis Sallufi**, i biri i Fatos-it, i lindur më 03.01.1980, në Peqin, Elbasan dhe banues në Lagjja Teqja, Elbasan, mbajtës i kartës së identitetit me nr. Personal I00103012D, në cilësinë e ortakut që zotëron 50% të vlerës së kuotave e barabartë me 1 kuotë me një vlerë të përgjithshme 15 000(pesëmbëdhjetë mijë)Euro

Kapitali themeltar është investuar nga ortakët themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Ortakët Themelues.

#### **NENI 6** **Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pakufizuar. Afati i aktiviteti fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

#### **NENI 7** **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cilët zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i parë i Shoqërisë është **Ervis Sallufi**, i biri i Fatos-it, i lindur më 03.01.1980, në Peqin, Elbasan dhe banues në Lagjja Teqja, Elbasan. Person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i mjetit të identifikimit letërnjoftimit nr. I00103012D, me një afat emërimi prej 5 (pesë) vitesh, afat ky fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria do të përfaqësohet përpara ç'do organi administrativ, gjyqësor, apo ç'do entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

#### **NENI 8** **Eksperti Kontabël**

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

*Ervis Sallufi*

2